



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
KRYETARI

Nr. 3080 Prot.

Fier, më 07/04/2023

VENDIM

Nr. 02 datë 07/04/2023

PËR

përcaktimin e vendeve publike në territorin e Bashkisë Fier për afishimin prej partive politike dhe subjekteve zgjedhore të materialeve propagandistike për Zgjedhjet Vendore të datës 14 Maj 2023

Në mbështetje të nenit 21 pika 1, nenit 3 pika 5, nenit 77 pika 1, nenit 78 pika 1 dhe 4, nenit 79 dhe nenit 88 të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "**Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë**" i ndryshuar, në mbështetje të nenit 24/2, pika 4 dhe 5 të Ligjit nr.8580, datë 17.02.2000 "**Për partitë Politike**" i ndryshuar me ligjin nr. 90/2017 "**Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike"**", në Ligjin nr.139/2015 "**Për vetëqeverisjen vendore**" i ndryshuar, në zbatim të Udhëzimit Nr.6, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve (KQZ) "**Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore**", në kuadër të zhvillimit të një fushate elektorale të rregullt e korrekte, në kuadër të respektimit dhe mbajtjes pastër të hapësirave publike të bashkisë, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Fier,

VENDOSA:

- 1- Të caktoj vendet publike në territorin e Bashkisë Fier për afishimin prej partive politike dhe subjekteve zgjedhore të materialeve propagandistike, për Zgjedhjet Vendore të datës 14 Maj 2023, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.
- 2- Subjektet zgjedhore lejohen të ngrenë jo më shumë se **1 (një)** zyrë zgjedhore (*elektorale*) për lagje qyteti ose fshat. Subjektet zgjedhore janë të detyruar të njoftojnë me shkrim Kryetarin e Bashkisë Fier, për adresat e sakta të zyrave elektorale në territorin e Bashkisë Fier, jo më vonë se **35 ditë** para datës së zgjedhjeve.

- 3- Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore përdorimi dhe afishimi i materialeve propagandistike zgjedhore statike, përfshirë flamuj dhe postera, lejohet vetëm në një distancë *(në një largësi)* prej jo më shumë se **5 (pesë) metra** nga zyra zgjedhore *(elektorale)* e partisë politike apo subjektit zgjedhor përkatës dhe jo më parë se 30 (tridhjetë) ditë para datës së zgjedhjeve.
- 4- Të gjitha materialet propagandistike vizive që përdoren në fushatë duhet të shoqërohen me shënimin: “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të.....” (vijon emri i subjektit zgjedhor).
- 5- Ndalohet përdorimi dhe afishimi i materialeve propagandistike që mund të ndodhen në qendrën e votimit dhe rreth saj në një rreze prej 300 m.
- 6- Ndalohet përdorimi i materialeve propaganduese me natyrë ndotëse *(përdorimi i bojrave të ndryshme ose spray paint për shkrimin e parullave elektorale në mure apo në vende publike, vendosja në shtylla, etj.)*, si dhe përdorimi i materialeve propaganduese në kundërshtim me përcaktimet e bëra në këtë vendim, që përbëjnë dëmtim apo cënim të hapësirave apo investimeve publike, të cilat do të rikuperohen në gjendjen fillestare me kosto të vet partisë politike apo subjektit zgjedhor përkatës.
- 7- Bashkia, nëpërmjet organeve të zbatimit të ligjit në varësi të saj, do të heq menjëherë të gjitha materialet propagandistike të subjekteve zgjedhore, që janë afishuar në vende jashtë përcaktimeve të këtij vendimi dhe që janë në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe vendimet/udhëzimet e KQZ-së.
- 8- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Kundravajtjeve Administrative, Emergjencave Civile dhe IVMT, Policia Bashkiake, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Infrastrukturës, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Fier, Ndërmarrja e Shërbimeve Rurale Fier.
- 9- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Armando SUBASHI

**me autorizim
Zv.Kryetari**

Ardius OLLDASHI

